



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 5 gusht 2013  
Nr. ref.: RK456/13

## **VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA**

në

**Rastin nr. KI16/13**

Parashtrues

**Armond Morina, drejtor i “Morina films” nga Prishtina**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II C. nr. 13/2011 të 28 shkurtit 2012**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Armond Morina nga Prishtina, drejtor i “Morina Films” nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës, më 28 shtator 2012, kontestoi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II C. 13/2011, të 28 shkurtit 2012. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur në mënyrë specifike se cilat nene të Kushtetutës pretendohet të jenë shkelur me këtë aktgjykim.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 dhe 56.2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

4. Më 20 shtator 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
5. Më 25 mars 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi informacione lidhur me statusin e rastit të tij në gjykatat e rregullta, si dhe të specifikojë se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur në rastin e tij.
6. Më 16 prill 2013, parashtruesi i kërkoi Gjykatës *„që rasti KI 16-13, i 20 shtatorit 2012, të tërhiqet përkohësisht deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës së Apelit.“*
7. Më 14 qershor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

8. Parashtruesi i kërkesës, si autor i projektit filmik me titull *„Mysafir në sofër“* kishte qenë në bisedime me Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit (në tekstin e mëtejme: MKRS) për financim të mundshëm të projektit nga kjo ministri.
9. Në seancat e mbajtura më 27 shtator dhe 4 tetor 2006, MKRS-ja e miratoi në parim projektin filmik të parashtruesit të kërkesës.
10. Më 9 tetor 2006, MKRS-ja e informoi parashtruesin e kërkesës se do të mbështesë projektin filmik *„Mysafir në sofër“*.
11. Më 30 janar 2007, MKRS-ja nënshkroi kontratë me parashtruesin e kërkesës, me të cilën përcakton obligimet e të dyja palëve për zbatimin e këtij projekti dhe përcakton shumën e subvencionit të MKRS-së.



12. Më 19 shtator 2008, MKRS-ja nënshkroi një aneks të kontratës me parashtruesin e kërkesës, përmes të cilit konfirmohej gatishmëria e Ministrisë për të përmbushur obligimet për të cilat ishin pajtuar MKRS-ja dhe parashtruesi i kërkesës për realizimin e fazës së parë të projektit filmik „*Mysafir në sofër*“.
13. Më 20 tetor 2008, MKRS-ja i transferoi parashtruesit të kërkesës fondet e dedikuara për realizimin e fazës së parë të projektit filmik „*Mysafir në sofër*“.
14. Më 15 prill 2010, sekretari i përhershëm i MKRS-së themeloi një komision prej katër anëtarësh për të monitoruar rrjedhën e realizimit të projektit „*Mysafir në sofër*“.
15. Më 30 qershor 2010, Departamenti i Auditimit të brendshëm të MKRS-së kishte bërë auditimin e dokumentacionit lidhur me projektin filmik „*Mysafir në sofër*“.
16. Më 27 gusht 2010, MKRS-ja e informoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të të gjeturave nga auditimi i MKRS-së si dhe nga raporti i komisionit të MKRS-së, ishte vendosur që të ndërpritej mbështetja e Ministrisë për projektin „*Mysafir në sofër*“ dhe, me atë rast, e urdhëroi parashtruesin e kërkesës që t'i kthejë mjetet e ndara për fazën e parë të këtij projekti.
17. Në ndërkohë, MKRS-ja ushtroi padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, me kërkesë që parashtruesi i kërkesës (Morina Films) „*t'i kthejë fondet e subvencionit të marra për realizimin e projektit filmik*“.
18. Më 28 shkurt 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë (II. C. nr. 13/2011) e miratoi padinë e MKRS-së si të bazuar dhe e obligoi parashtruesin e kërkesës që MKRS-së t'ia kthejë fondet e subvencionit, duke përfshirë kamatën e përcaktuar ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.
19. Më 21 maj 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut.
20. Më 22 gusht 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë e refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme.
21. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktvendimit në fjalë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, duke pretenduar se e kishte paraqitur ankesën brenda afatit ligjor dhe kërkoi që Gjykata Supreme të anulojë aktvendimin e kontestuar.
22. Parashtruesi i kërkesës ka informuar se procedura në Gjykatën Supreme është ende duke u zhvilluar.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

23. Kushtet e pranueshmërisë janë të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të specifikuara në Ligj dhe Rregullore të punës.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon:

*„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj“.*

25. Siç u cek më sipër, procedurat pranë Gjykatës Supreme janë ende duke u zhvilluar. Kësisoj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar ende të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe kërkesa është e parakohshme. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës ende ka të drejtë të parashtrojë kërkesë të re në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme brenda afateve të përcaktuara me ligj.
26. Për më tepër, në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara me rregullin 32 të Rregullores së punës.
27. Rregulli 32 i Rregullores së punës, në pjesën që ka të bëjë me këtë, parasheh që:

*“Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes*

*(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.*

*(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të. [...]*“

28. Gjykata, duke i marrë parasysh rrethanat e cekura më lart, nuk gjen ndonjë arsye për të vendosur përkitazi me kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa do të hiqet nga lista.




## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 23 të Ligjit dhe rregullin 32 të Rregullores së punës, më 14 qershor 2013, njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën e parashtruar;
- II. T'UA komunikojë vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafin 4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani